

Dr. Hakif Bajrami

## QËNDRIMI I JUGOSLLAVISË MONARKISTE NDAJ ARSIMIT DHE KULTURËS SË SHQIPTARËVE NË KOSOVË (1918—1941)

### 1. Përpjekjet për hapjen e shkollave shqipe dhe pengesat ndaj tyre

Me kërkesën e Ministrisë së arsimit, më 7 nëntor 1919 kërkoheshin të dhënat për veprimtarinë e shkollave në territorin e Kosovës deri më 1919.<sup>1</sup> Lidhur me këtë kërkesë, inspektori i arsimit më 19 nëntor 1919 dërgoi në Beograd një raport, ku paraqitet në hollësi problemi i shkollimit dhe një histori e shkurtër e shkollave në territorin e Kosovës.

Periudhën e qeverisjes otomane në këtë anë, thuhet në dokument, (kishte shkolla shtetërore ekskluzivisht në gjuhën turke) e karakterizon padija dhe prapambetja e përgjithshme arsimore e popullit. Në këtë anë ka pasur edhe shkolla kombëtare serbe, bullgare, greke, rumune, si dhe shkolla shqipe të katolikëve, të hapura me ndihmën e privilegjeve të udhëheqjeve kishtarë. Shkollat shtetërore ishin: sibian mektebi (foshnjore), iptidane-mektebi (shkolla fillore), ruzhdije (gjimnazet e ulta), idadije (gjimnazet e larta) dhe medresetë (shkolla fetare). Nga shkollat konfesionale në këtë anë ishin: një shkollë greke në Prizren me 4 klasë dhe e pranuar nga pushteti dhe nga një shkollë greke dhe rumune të papranuara në Ferizaj. Shkolla katolike vepronte në Janjevë, rrethi i Graçanicës, dhe në Letnicë, rrethi i Gjilanit. Në gjuhën shqipe vepronte shkolla në Prizren, sidomos ajo e meshkujve dhe e femrave, pastaj në Ferizaj dhe në fshatin Stubëll rrethi i Gjilanit.

<sup>1</sup> AJ, s. 66, k. 7, d. pov. nr. 62, 7 nëntor 1919 — telegram. Se në çfarë mase u muarrën nëpër këmbë të drejtat e shqiptarëve gjatë sundimit otoman dëshmon fakti se ata gjithnjë e më tepër po interesoheshin për shkollën dhe lavrimin e kulturës kombëtare. Në këtë drejtim sidomos ishte i interesuar Hasan Prishtina, me iniciativën e të cilit ishin hapur shumë mësojtore. Lidhur me këtë shiko gjërisht: Dr. Jashar Rexhepagiq, *Skolstvo i prosjeta na Kosovo od kraja XVIII stoleca do 1918*, Prishtinë, 1974, f. 140—144. dhe 147; shih: Ballkanikus, *Albanski problem i Srbija i Austrougarska*, Beograd, 1913, f. 11. „Arbanasi nemaju narođne literature, narodnih umotvorenine od tole kakve vrednosti”. Protiqi mbështet në disa vështrime shoviniste duke i krahasuar shqiptarët me primitivizimin e Afrikës; shih AJ. s. 66. k. 7, d. po. nr. 1. XIX, 11 maj 1919.

Shkolla shqipe e meshkujve ishte në Gjakovë dhe në Pejë, si dhe shkolla e përzier në Zllokuqan dhe e mashkujve në Budisalcë, Qarku i Dukagjinit. Shkrimleximi në këtë shkollë zhvillohej në gjuhën latine.<sup>2</sup>

Edhe njëra edhe tjetra fazë e shkollave ishin legalisht propagandistike. Shkolla greke, për shembull, i mbante fondi „Svetispasa”, në Prizren, si dhe qeveria greke, shkolla rumune Rumunia, ndërsa shkollat katolike shqiptare Austria, nëpërmjet konsullit të vet në Shkup, si arqipeshkopata e katolikëve në Prizren. Lidhur me këtë në raporte thuhet pas vitit 1912 tërë situata në këto anë ndryshon. Vetëm, mbahen shkollat në gjuhën serbe, ndërsa shkollat në gjuhën turke mbyllen që të gjitha. Në këtë mënyrë mbyllen edhe shkollat rumune dhe greke. Por, jo për shkak të dhunës, po për shkak se nuk kishin fëmijë, sepse fëmijët e tyre që ndiheshin si rumunë dhe grekë, pjesëtarët e këtyre kombësive i dërgonin në shkollë në gjuhën serbishte. Shkollat shqiptare katolike gjithashtu ndalohen.<sup>3</sup>

Gjatë viteve 1912—1915 në Kosovë, thuhet në raporte, „muslimanët” nuk kishin shkollë të veten me përjashtim të një medreseje të ulët në Gjilan dhe një në Novi Pazar lloj shkolle fetare e ulët, në të cilat vijonin fëmijët pasi kryenin shkollën fillore ose pa të. Në Medresën e Gjilanit gjatë vitit shkollor 1914—1915 mësimet i vijonin 26 nxënës, ndërsa në Novi Pazar gjatë këtij viti shkollor mësimet i vijonin 22 nxënës. Medresetë e tilla mbaheshin nga vakufët, ndërsa një pjesë të vogël të mjeteve e jepnin edhe nxënësit si pagesë në natyrë (drith, vet, tlyen, qingja e të tjerë) hoxhollarëve — mësuesve. Në të fëmijët përgatiteshin për imam fshatrash dhe nëpunës fetarë nëpër xhamia.<sup>4</sup>

Fëmijët e muslimanëve (lexo shqiptarëve) që duhej të shkonin në shkollën fillore, shkonin në shkollën shtetërore të përzier me fëmijët serbë, por kishte edhe aso shkollash ku mësimi zhvillohej në gjuhën serbe. Por, fëmijët ishin të ndarë sipas kombësisë. Shumica e fëmijëve të shqiptarëve shkollën e ndiqnin në Prizren, Prishtinë, Mitrovicë, Vuçiternë, Pazar, Gjilan, Ferizaj, Sjenicë, Prijepole, si dhe në disa fshatra të rrethit Gjilanit dhe të Ferizajit. Në përgjithësi, në tërë territorin e Kosovës, thuhet në raporte, në shkollat shtetërore, do të thotë në gjuhën serbe, nga kombësia shqiptare ishin 2245 nxënës, por numri do të ishte edhe më i madh, thekson raporti, sikur të kishte mësues dhe ndërtesa shkollore, sepse shumica e vendeve kanë kërkuar hapjen e shkollave dhe sigurimin e mësuesve.<sup>5</sup>

Në shkollat ku ishin të pranishëm fëmijët shqiptarë, para ditë i mësonin mësuesit shtetërorë sipas programit për shkolla fillore, ndërsa pasdite mbanin mësim hoxhollarët, ku mësohej: kurani, shkenca mbi fenë dhe shkrimi në turqishte. Edhe mësuesit e parë edhe hoxhollarët, theksojnë dokumentet i paguante shteti

<sup>2</sup> *Po aty.*

<sup>3</sup> *AJ*, s. 66, k. 7, d. pov. nr. 1, Raport i gjerë.

<sup>4</sup> *Po aty.*

<sup>5</sup> *Po aty;* *AJ*, s. 14, f. 102, telegrame.

dhe se këta konsideroheshin nëpunës shtetëror.<sup>6</sup> Askush në atë kohë, thuhet në raporte, nuk ka kërkuar shkolla në gjuhën shqipe, prandaj edhe aso shkollash nuk pati.<sup>7</sup> Se kjo nuk qëndron, më së miri vërteton fakti se nëpër Kosovë ishin formuar shoqata të ndryshme kombëtare me të cilat udhëhiqte Komiteti i Kosovës, sidomos në Pejë, Gjakovë, Prizren, Prishtinë dhe në Mitrovicë ku kërkohej lavrimi i shqipes.\*

Shkollat katolike shqiptare, thuhet në dokumente, kanë vepëruar deri më 14 korrik 1914 në Janjevë, ku mësimi zhvillohej në gjuhën serbe dhe se nxënësit ishin të përzier. Në këtë shkollë i vijonin mësimet 196 nxënës. Shkolla e tillë mbahej edhe në Letnicë në gjuhën serbokroate me 34 nxënës, por në këtë shkollë ishin të pranishëm vetëm meshkujt. Në Stubullë në gjuhën shqipe shkollën e meshkujve e ndiqnin 18 nxënës. Në Ferizaj në gjuhën shqipe vepronte një shkollë me 12 nxënës, ndërsa shkolla e ngjashme në Prizren, ku mësimi zhvillohej në gjuhën shqipe, kishte 164 nxënës, pjesërisht në foshnjore e pjesërisht në shkollë fillore të përzier. Në Gjakovë dhe në Pejë nuk kemi arritur të sigurojmë të dhëna për shkollat katolike shqiptare, por jemi të mendimit se, sipas të gjitha gjasëve, meqë mungojnë dokumentet, shkolla të tilla nuk ka pasur. Të gjitha shkollat shqipe të ashtuquajtura „katolike” në Kosovë i mbante Austria, e cila i siguronte librat, i paguante mësuesit, u jepte ndihmë fëmijëve, mbikëqyrte ndërtesat nëpërmjet konsullit austriak në Shkup. Në Janjevë mësimet në gjuhën shqipe, sipas dokumenteve, i zhvillonin njerëzit që nuk merreshin me fe, pa përgatitje të duhur, ndërsa në vendet e tjera, rëndom, mësimin e mbanin priftërinjtë. Me këto shkolla vazhdimisht udhëhiqte Peshkopata e Prizrenit, ndërsa instruksionet i mernte nga Shkupi dhe, në fakt, të gjithë mësuesit ishin agjentë austriakë në këto anë. Por, me shpalljen e luftës nga ana e Austro-Hungarisë, interesimi për këtë shkollë bie në argjipeshkvinë e Prizrenit, e cila i mbante shkollat dhe i paguante mësuesit si dhe i ndihmonte nxënësit të varfër dhe i siguronte tekstet shkollore. Me një fjalë peshkopata e zavendësoi konsullin austriak të Shkupit. Deri në fillim të luftës punoi vetëm shkolla e Prizrenit, ndërsa të tjerat u mbyllën me motiv se mësuesit nuk kishin kualifikim. Mirëpo, pikërisht ata u mobilizuan të parët në kuadrin ushtarak në mënyrë që të pezullohej aktiviteti i tyre drejt emancipimit të shqiptarëve të konfesionit katolik.<sup>8</sup>

Në pjesën e Kosovës, e cila u okupua nga Austro-Hungaria, vepëruan edhe disa shkolla në gjuhën serbe. Mësuesit në këto shkolla u sollën nga jashtë si dhe disa vendas. Edhe në territorin e okupuar nga Bullgaria punuan disa shkolla, por mësimi në to zhvillohej vetëm në gjuhën bullgare. Shqiptarët në këtë kohë i kishin shkollat e veta fetare. Në këtë kohë, theksojnë raportet, me nxitjen e pushtetit austriak dhe bullgar, „për herë të parë” shqiptarët

<sup>6</sup> Po aty.

<sup>7</sup> Po aty.

\* Shiqo. DASIP. *Albanski odsek f. 1. d. „Xgjimi”*-Organ i Qeverisë I. Qemalit.

<sup>8</sup> Po aty.

në këto anë po kryejnë shkollë në gjuhën shqipe. Këso shkollash më së shumti kishte në Mitrovicë dhe në Pejë dhe se këto u shërbenin si shembull shkollave të tjera. Të gjitha përgatitjet u bënë që një shkollë shqipe të hapet edhe në Prishtinë, por koha nuk premtoi. Këto shkolla nxiste të hapën Hasan Prishtina dhe udhëheqësit e tjerë Kosovarë, si Bajram Curri, Negjip Draga e shumë të tjerë.<sup>9</sup> Me disa nxënës të këtyre shkollave patëm rastin edhe për të biseduar. Kurse informatat më të mira lidhur me shkollën e Mitrovicës na i ka dhënë nxënësi i saj Sylë Hysi — Popova.

Rrjedhimi i hapjes së këtyre shkollave shqiptare, theksojnë raportet, është fakti se „tani çpesh ndihet fjala se — unë jam shqiptar — për çka më parë kësi termash nuk ka pasur në këto anë dhe se shqiptari ska ditur, gjoja se cilit komb i takon. Edhe nëse e ka pyetur ndokush ai është përgjigjur: jam shqiptar, jam arrnaut, jam musliman e të tjera. Duhet pasur këtë në mendje dhe shqiptarëve myslimanë asesi nuk duhet ti u lejohet hapja e shkollave private në gjuhën shqipe me alfabet shqip, por vetëm në gjuhën turke, sepse vetëm në këtë mënyrë shqiptarëve duhet t'u tregohet se kanë lidhje me Perandorinë e dikurshme Osmane, në mënyrë që andej të gravitojnë dhe të shpërngulen”,<sup>10</sup> thekson raporti i vitit 1919.

Pas vitit 1918 filluan të punonin shkollat shqipe fetare në Prizren, si dhe në disa fshatra, sipas urdhëresës për shkollimin fillor me shifër rezervat nga Ministria e punëve të brendshme nr. 21010. Në shkollat shtetërore në këtë kohë fëmijët shqiptarë, sidomos në Prizren dhe në Prishtinë, nuk ishin të përfshirë. Sikur të kishte kuadër të mjaftueshëm që të hapeshin shkollat shtetërore dhe në fshatrat e mëdha për fëmijët shqiptarë, me këtë do të ishin të kënaqur edhe shqiptarët, por pak prej tyre do kërkonte shkolla private (shqipe), theksojnë raportet. Prandaj, është e nevojshme që edhe më tej të sjellim mësuës nga regjioni i Serbisë në regjionin e Kosovës, por me kusht që mësimi të zhvillohet vetëm në gjuhën serbokroate.<sup>11</sup>

Se shqiptarët nuk ishin të mendimit që mësimi të zhvillohet vetëm në gjuhën serbokroate, më së miri dëshmon fakti se Azem Bejta më 1919 në programin e tij parashihte hapjen e shkollave shqiptare.\*

Lidhur me politikën e shkollimit në Kosovë kemi disa raporte me interes, ku paraqitet situata reale sesi duhej të vepronin shkollat. Lidhur me këtë, pas një kohe shihet në të gjitha planet dhe programet e Ministrisë së arsimit se nuk ishte e „nevojshme”

<sup>9</sup> Po aty; Dr. Jashar Regjepagiq, *vep. e cit. f. 167* gjerësisht, te Hysë Popova gjetëm edhe fotografinë e shkollës së Mitrovicës të vitit 1917 dhe abetaren me të cilën mësoi: Shih DASIP MIDK Serbia, *Albanski odsek, f. 6. 1918, d. pov, nr. 573.*

<sup>10</sup> Po aty, ndjenjat kombëtare më së shumti në Kosovë i kanë përhapur shkollat „Haxhi Zeka” dhe „Skenderbeu” gjatë okupacionit 1915—1918.

<sup>11</sup> Po aty, *Ministarstvo prosveta nr. 6. 20. I. 1920.*

\* AQH RPSSH „MKK”, *Programi i kryengritjes, 8 pika e Azem Bejtës* fotokopje nga Mf. K. Kosovës.

të zbatoheshin ligjet sa i takon arsimit të fëmijëve shqiptarë. Kundër tyre tani vepronin xhandarët dhe policët e shumtë. Për shebull, në rrethin e Mitrovicës i dërgohet më 28 korrik të vitit 1919 një raport inspektorit të Ministrisë të arsimit, ku jepet një pasqyrë lidhur me shkollat në këtë regjion. Në dhjetë komuna që kanë punuar shkollat, thuhet, aty jetojnë 25362 banorë, prej tyre 2047 janë fëmijë të moshës shkollore. Numri i atyre që dijnë shkrimlexim në këtë rreth sillet rreth 2505, ndërsa i atyre që nuk dinë shkrimlexim është 21063. Në 6 komuna shkollat nuk punonin, sepse nuk kishte ndërtesa ose nuk kishte mësues. Në këto komuna vetëm 1 për qind e popullsisë dinte shkrimlexim. Edhe në 12 qendra të tjera nuk kishte kurrfarë shkollash për çka nuk mund të flitej për përhapjen e arsimit në këto anë. Prandaj fëmijët po regrutohen në analfabet të rinj.<sup>12</sup>

Shqiptarët, menjëherë pas riokupimit, më 1919, bënë kërkesa për hapjen e shkollave, kërkesa këto që u bënë në mënyrë të organizuar nga ana e organizatës „Bashkimi” (xhemjeti) si dhe nga Komiteti i Kosovës. Kërkesat i drejtuan Ministrisë së Arsimit të Mbretërisë Serbe-Kroate-Slllovene. Së këndejmi nga raportet mësojmë se administrata e shtetit të ri pat ndaluar çdo përpjekje në këtë drejtim, duke theksuar se hapja e shkollave në gjuhën e nacionaliteteve ishte çështje private, me „arsyetim” se ekzistonin shkollat shtetërore. Në urdhëresë thuhet: „Nuk lejohet hapja e kurrfarë shkolle që ka të bëjë me vetitë kombëtare edhe nëse me kërkesë nuk ceket qartë qëllimi i shkollës”. Duhej cekë formimi, si të gjendet ndërtesa, inventari shkollor, librat shkollore si dhe programi i tyre, plani i cili duhej të përpilohej dhe të përputhej me atë shtetëror. Duhej cekur numri i nxënësve të paraqitur në cilëndo gjuhë që zhvillohet mësimi, cilët arsimtarë do të japin mësim dhe a u përgjigjen, ata kualifikimeve dhe se pronari i shkollës se ka parë për rroga, që të pajtohet që ministri i arsimit të i propozojë arsimtarët, që në shkollë themeluesi privat të deklarohet se nuk do të keqpërdorë për qëllime antishtetërore, që të pajtohet se ndaj asaj shkolle të bëhet inspektimi shtetëror e të tjera. Këtë urdhëresë që e nënshkroi Svetozar Pribiqeviq., shqiptarët në Kosovë me të gjitha mundësitë u angazhuan për të realizuar në disa mese, por prej 15 kushteve që figuronin gjithmonë mungonin nga një deri në 5 e 10 kushte, kështu që për shkaqe të „mosplotësimit të kërkesave ligjore”,<sup>13</sup> shkollat shqipe nuk u hapën. Në fakt, pushteti serbomadsh shkollën shqipe menjëherë e ndaloi, ndërsa këto manovrime kishin për qëllim të dilnin në sipërfaqe „nacionalistët” shqiptarë me kërkesa „private” për hapjen e shkollave, në mënyrë që policia më vonë të i likuidonte më lehtë. Me këtë policia dëshironte të kishte material të çmuar se cilët shqiptarë angazhoheshin për emancipimin e tyre kombëtar. Kuptohet, në këtë drejtim policia pati material të çmuar, sepse një pjesë e madhe e nacionalistëve shqiptarë prej të gjitha rretheve kërkoi shkollë shqipe, qoftë edhe ta mbante privatisht.

<sup>12</sup> AJ, S. 66, k. 7, d. 479, 28. VIII. 1919.

<sup>13</sup> AJ, M. prosvete, poverliiva arhiva S. 66, k. 7, d. nr. 1684 — privatne škole.

Për këtë diskriminimi kulturor, ja se ç'shkruan në një teleg-ram dërguar nga Peja Ministrisë së punëve të brendshme: „Na-çallniku i qarkut të Pejës me telegram të shifruar lajmëron këtu se është zënë letra e Ketë Proviqit, më parë drejtor i shkollave shqiptare në regjionin e Plavë-Gusisë e më vonë në Gjakovë. Tani Keta, gjendej në grupin e dytë të oficerëve të zënë rob në Lesko-vac. Ai ju shkruan 4 mësuesve shqiptarë në Gjakovë dhe i këshi-llon ata që t'ia dërgojnë 200 dinarë hua në mënyrë që ky ato para ti përdorë si rufshetë për të dalë nga burgu. Në fund të letrës mba-ron me „rroftë Shqipëria”. Ky si shqiptar thekson raportuesi është shumë i rrezikshëm dhe se prania e tij duhet të jetë në duart e pushtetit ushtarak, sepse misioni i mësuesit shqiptar paraqet rre-zik shtetin”.<sup>14</sup>

Për aktivitetin e shqiptarëve për shkollën shqipe është me in-teres edhe një raport i Myftisë së Vuçitërnës dërguar Ministrisë së fesë. Në të thuhet se muslimanët (lexo shqiptarët) në Mitrovicë e mbajtën një tubim dhe, ndër të tjera, ishte në rend dite edhe çështja e arsimimit të fëmijëve, shqiptar ku u miratua ve-ndimi që fëmijët më së paku të mësojnë shkencat fetare turke, për çka këtij vendimi nuk i kundërshtuam. Në tubim më pyetën, thekson Myftiu, se në Vuçitërnë fëmijët e shqiptarëve çfarë më-sojnë, në çfarë gjuhe. Në këtë pyetje, vazhdon ai, u jam përgjigjur se shkojnë në shkollë dhe se i kanë paralelet e ndara, ku para dite mësojnë shkencën e fesë dhe gjuhën turke që këtë punë e bëjnë hoxhollarët, ndërsa pasdite në gjuhën serbe ku mësojnë serbisht, matematikë, si dhe njohuri natyre me bukurshkrim, ku mësimin e mbajnë serbët. Në këtë përgjigje timen Ferat Bej Draga nga Mitrovica, thekson më tej Myftiu, e mori fjalën dhe tha se kjo punë nuk është e mirë dhe se ai në asnjë mënyrë nuk do e lejonte fëmijën e vet në atë shkollë. Sepse neve shkolla më e mirë na duket se është ajo shkollë ku mësohet në gjuhën shqipe, pasi-çë popullsia nëpër fshatra serbisht nuk di, prandaj i tërë mësimi duhej të zhvillohej shqip. Në këtë kundërshtim, thotë Myftiu ju përgjigja se deri më ardhjen e austriakëve neve shkollë nuk kemi pasur, por kemi pasur myderriz të mirë, myfti e hoxhollarë, treg-tarë të tjerë, edhe pse ata ishin shqiptarë dhe e dinin gjuhën turke dhe ishin qytetarë të ndershëm, si: Haxhi Alia — myderriz nga Gjakova, Salih Efendija, Abdyl Ali Efendia nga Vllahia, të cilët i kanë njohur një regjion shumë i gjerë. Programin e shkollës shqi-pe myftiu e bën „Program italian”, pra shihet për çfarë është fjala. Duke vërejtur tendencën e të pranishmëve se ishin të vendosur vetëm për shkollë shqipe, i nderuari ministër vendosa ta lëshojë mbledhjen në shenj proteste, përfundon ky agjent i pushtetit. Li-dhur me këtë Ferat Draga kishte folur në mbledhje se paradite nxënësit mësojnë për fe e pas dite sërish për kombën që nuk e njohin e „kjo do të thotë më mirë të mos mësojnë fare”.<sup>15</sup>

<sup>14</sup> AJ, M. prosvete 66, k. 77. d. pov. 2160; AJ, s. 66, k. 22, d. pov. nr. 1. Në Pazar popullsia nuk dëshiron t'i dërgojë fëmijët në shkollën serbe. Lidhur me këtë masat e ndërmarra policia AJ 66. 77 d. pov. pashifër.

<sup>15</sup> AJ, S. 66, k. 7, d. pov. nr. 171, 3 shtator 1919, myftia i Vuçitërnës.

Sipas Ligjit mbi shkollat popullore, mësimi në shkollat e pakicave thuhet se zhvillohej në gjuhën amtare, ndërsa gjuha serbo-kroate ishte e obliguar për t'u mësuar, sipas këtij ligji, 6 orë në javë. Shkolla e pakicave kombëtare, thuhet aty, hapet me propozimin e prindërve të fëmijëve, të cilët e shchin të arsyeshme hapjen e shkollave dhe për të interesohen.<sup>16</sup> Nga kjo shihet se hapja e shkollës shqipe me ligj nuk ishte e ndaluar, por qarqet reaksionare borgjeze sërëbomëdha e pengonin realizimin e kësaj të drejte, e cila në Kosovë nuk u kërkua vetëm në mënyrë demokratike por edhe me armë.<sup>17</sup> Lidhur me këtë Azem Galica në fushë të Zhabarit kërkoi edhe këtë „Të lejohet hapja e shkollave shqipe dhe gjuha shqipe të jetë gjuhë zyrtare, si dhe nëpunësit e huaj të zëvendësohen me nëpunës shqiptarë”.<sup>18</sup>

Pas vitit 1918 në Kosovë pushteti lejoi të vazhdohet shkollimi në Janjevë në gjuhën serbe për katolikë, në gjuhën shqipe në Prizren dhe në Stubëll, ku aktivitetin kryesor arsimor-edukativ e zhvillonte njëfarë prifti i quajtur Mjeda, por përkundër përpjekjeve të tij, mësimi zhvillohej me vështirësi të mëdha, sepse inspektori i arsimit e pengonte punën e shkollave, edhe pse ato ishin me programe fetare.<sup>19</sup>

Agjentët e Pashiqit, duke vërejtur se në Kosovë edhe feja islame mund t'u ndihmonte shqiptarëve nëpër të ashtuquajturat shkollat fetare, gjë që ka pasur të drejtë, urdhëroi të shënoheshin me përpikëri të gjithë imamët e xhamive dhe të mirreshin shënimet për ta. Në raporte figuron se ata ishin „njerëz të, rrezikshëm”, dhe se në çdo moment ishin në gjendje t'i nxitnin shqiptarët. Lidhur me këtë një inspektor shkruan se „imamët janë baruti më i terur dhe më i rrezikshëm, të cilët janë gjithmonë fanatike kundër krishtërit”. Nëse politikani është kundër shtetit, këta janë edhe kundër shtetit tonë që fillon në kryq, por edhe kundër fesë sonë që është e bazuar në Bibël, prandaj këtyre duhet t'u gjejmë rrugë. Rruga më e mirë do të ishte përdorimi i dhunës në mënyrë që këta të shpërnguleshin, thekson raportuesi. Në tërë Kosovën, sipas të dhënave rezervat të pushtetit, diku nga viti 1920 vepronin 276 imamë me shkollim adekuat. Sipas shënimeve arkivale që i kishte përpiluar policia, të gjithë këta ishin „të orientuar drejt shqiptarizmit”. Në radhët e tyre të paktë ishin ata që besimtarëve të vet nuk u folnin për shqiptarët, sepse instruksionet i merrnin nga Ferat Draga, Bajram Curri, Hasan Prishtina e shumë anëtarë nderi të Komitetit të Kosovës. Kishte në radhët e tyre edhe të atillë që kishin kryer shkolla fetare dhe në masë fanatike ishin të dhënë pas fesë. Sipas shënimeve që kemi arrit ti tubojmë, të gjithë hoxhollarët, imamët e xhamive ishin ose anëtarë të Komitetit të Kosovës ose anëtar të këshillave të „Bashkimit” (xhemjetit) nëpër qytete, ndërsa nëpër fshatra ata ishin rëndom, kryetarë këshillash. Prej tyre këërkohej organizimi i popullsisë në frymën kombëtare.

<sup>16</sup> AJ, S. 80, k. 29, nr. 1—20; *Zakon o narodnim manjinama*.

<sup>17</sup> H. Bajrami, *Kosta Novakoviç*, „Përparimi”, nr. 6. 1977.

<sup>18</sup> Shik: Ajet Haxhiun, *Shota dhe Azem Galica*. . . f. 89.

<sup>19</sup> AJ, s. 66, k. 22, d. pov. 1434. d. pov. 85. d. pov. 117. d. pov. 92. d. pov.

Aktivitetin kryesor kombëtar imamët e xhamive e përqëndronin duke i mësuar shqiptarët se me çdo kusht duhej ta ruanin plisin si simbol kombëtar. Heqja e plisit, u thuhej atyre, do të thotë ndërrimi i fesë, do të thotë gjoja dalja nga islamizmi. Ky aksion ishte mirë i analizuar dhe i qëlluar për ruajtjen e simboleve dhe të ndjenjës kombëtare në përgjithësi të ashtuquajturën nebulozën fetare. Pashiqi, duke vërejtur këtë, urdhëroi që disa prej tyre (hoxhollarëve) të „bliheshin” e disa të shpërnguleshin. Lidhur me këtë në një masë ia arriti qëllimit, sepse për një kohë të shkurtër nacionalistët më të mëdhenjë nga radhët e tyre arriti t’i përçante ose t’i likuidonte.<sup>20</sup>

Edhe pse përdorimin e gjuhës shqipe nëpër shkolla pushteti në ish Jugosllavinë kurrë nuk e gjykoj publikisht, prapëseprapë, përdorimi i kësaj gjuhe në jetën private dhe publike në mënyrë të ndryshme gjithmonë që i ndaluar, sepse popullsinë shqiptare kurrë nuk e pranoi si të tillë, ndaj popullsia shqiptare konsiderohej element i rrezikshëm.<sup>21</sup>

## 2. Përpyjekjet legale dhe ilegale të shqiptarëve për shkollë dhe arsimim kombëtar

Organizata „Bashkimi” ishte e vetmja themelatë politike e institucionalizuar, e cila ia bëri të ditur borgjezisë serbomadhe se nuk e kishte ndër mend (edhe pse kjo organizatë nuk ishte radikale në aksione si, bie fjala, „Komiteti i Kosovës” dhe lëvizja kombëtare e udhëhequr prej tij), të pajtohej me qëndrimin e pushtetit ndaj shkollave shqipe. Përkundrazi, Partia politike „Bashkimi” gjithmonë në programin e vet pati parasysh dhe vuri theksin në shkollën shqipe. Dihet se popullsia shqiptare ishte e pauperizuar dhe se ajo duhej të „mbahej” në pozitë koloniale. Ndaj këtij qëndrimi legalisht protestoi Ferat Draga, kryetar i „Bashkimit”. Lidhur me pozitën e mjeruar arsimore të shqiptarëve dhe të drejtat e tyre ai tha me 11 tetor 1923 në parlament, pas disa provokimeve: „Unë nuk jam turk, zotëri, unë jam për nga feja musliman, për nga kombësia jam shqiptar më i lashtë se ju në Ballkan, që kemi të drejtë në jetë së bashku. Ne, zotëri, prej radikalëve skemi kërkuar asgjë tjetër përpos asaj që e lejon Kushtetuta dhe ligji në fuqi. Prej tërë kësaj, zotëri, ne kemi fituar pak. Ne shkolla nuk kemi edhe pse këtë Kushtetuta e garanton, ne nuk mund të hapim shkolla në gjuhën shqipe, përkundër asaj që Ligji na e lejon, prandaj ju Ligjin e merrni si diçka sekundare...”<sup>22</sup> „Bashkimi” në të gjitha kongreset e veta i kushtoi gjithashtu rëndësi çështjes së

<sup>20</sup> AJ, M. pravde, s. 63, k. 30 — lista e imamëve shqiptarë prej të cilëve shumica u likuiduan më vonë. Për imamët thuhej se janë barikadë kryesore që nuk lejojnë të perzihet shtëpia e shqiptarit më atë e serbit”...

<sup>21</sup> *Kulturno prosvetni pokret, albanaca u Jugoslaviji 1918—1941*, punim në dorëshkrim i lexuar në Kongresin e Historianëve të Jugosllavisë në Novi Sad (M.P)

<sup>22</sup> Shik; fjala e Ferat Dragës në parlament: „Hak”, nr. 643, 17 tetor 1923, f. 1—2.



shkollimit të popullsisë shqiptare, ndërsa këtë problem në mënyrë të veçantë e theksoi në Kongresin e tretë.<sup>23</sup>

„Rreziku nga gjuha shqipe dhe propaganda komuniste”, për borgjezinë serbomadhe pothuajse e kishte të njejtën peshë. Lidhur me këtë Ministria e arsimit në Beograd i dërgoi inspektoratit arsimor një urdhëresë që të dërgoheshin të gjitha informatat për mësuesit komunistë në Kosovë, ku theksohej se ata e konsideronin mësimin në gjuhën shqipe të natyrshme dhe pa kurrfarë rreziku. Lidhur me këtë pasojë telegrame nga Tetova, Mitrovica, Prizreni, Gjilani, Peja, Prishtina, Novi Pazari e të tjera, ku qarqet policore theksojnë se deri në fund të vitit 1921 nuk „kishin lënë” gjurmë të komunistëve në Kosovë dhe se krahas ndjekjes së komunistëve, ishin luftuar edhe të gjitha ato shenja që „flitnin” për shkollimin në dobi të shqiptarëve, të rrezikshëm për Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene.<sup>24</sup>

Meqë shqiptarët i rezistonin mënyrës së edukimit dhe të arsimit në shkollën borgjeze serbe, në një raport të ministrisë së fesë, dërguar Pleqësisë kryesore të arsimit në ministrinë e arsimit, theksohet se në Serbinë Jugore problemi i shkollimit të shqiptarëve gjithnjë e më tepër po bëhet i komplikuar. Kërkesat shtetërore janë që ky problem sa më parë të rregullohet dhe rregullimi të bëhet në interes të shtetit. Në Serbinë Jugore, thuhet në raport, tani janë 50 myftinj dhe 600 imamë, prej të cilëve asnjëri nuk din ose nuk do të dijë mirë gjuhën shtetërore. Këta gati të gjithë janë nacionalistë shqiptarë, prandaj edhe hapja e medreseve ku këta udhëheqin, është rrezik i përhershëm për „interesat kombëtare” të shtetit tonë, sepse në këto shkolla „fëmijët, megjithatë, po edukohen në frymën armiqësore, ku shpesh përmendet termi shqiptar”. Meqë jemi të interesuar për edukatë kombëtare shtetërore, thekson raporti, jemi të interesuar që sa më parë në Shkup të themelohet një medrese, e cila do të jetë në mbikëqyrje të shtetit dhe se aty shqiptarët do të edukohen në frymën thjesht fetare, por për interesat e shtetit tonë.<sup>25</sup> Shkolla do të hapet por rezultatet dhe realiteti do të tregojnë kundërtën.

Gjatë 22 vjetëve të Monarkisë Jugosllave qarqet borgjeze e malltregonin pa masë popullsinë shqiptare. Ja ç’shkruan ministri i Punëve të jashtme, Paralelja e dytë politike, ministrit të Arsimit, Trifkoviçit, më 6 qershor 1923: „Konventën mbi pakicat na e kanë imponuar fuqitë e mëdha. Kjo konventë është pritur për situatë më stabile në Evropë. Por, në praktikë po tregohet e kundërta, se pakicat janë vetëm të ne, por edhe jashtë shtetit tonë. Ato çka nuk po munden në mënyrë legale, po kërkojnë me armë shkolla dhe të drejta kombëtare. Kjo po manifestohet sidomos në Kosovë”.<sup>26</sup>

Propaganda borgjeze serbomadhe përnapte dezinformime se gjoja shqiptarët nuk dëshirojnë shkollë se „kanë dëshirë të jetoj-

<sup>23</sup> *Južna serbija II, 1922, Treći kongres Djemjeta; ACK KPJ. XIV. 3—1. gospodinu presetniku Nikoli Pašiču.*

<sup>24</sup> AJ, s. 66, k. 52, d. pov. 9; d. pov. 376; d. pov. 3; d. pov. 762; d. pov. 224; d. pov. 7, etj.

<sup>25</sup> AJ, s. 63, k. 137, d. nr. 3878; d. nr. 437; d. nr. 19392.

<sup>26</sup> AJ, s. 66, k. 7, d. pov. 488.

në në anarki të egër dhe pa shkolla”, siç mësonte Ballkaniku si, Vlladan Gjorgjeviqi e të tjerë. Demantimi i tërë kësaj, thekson raporti i vicekonsullit jugosllav në Shqipëri është mësyemja gjithnjë e më e madhe e fëmijëve shqiptarë nga Kosova në Shqipëri për shkollim, përkundër urdhrit të Ministrisë së punëve të jashtme që kjo tendencë të pengohet. Se kjo punë bëhet në mënyrë të organizuar vërteton fakti, thuhet në raport se vetëm në vitin 1924 kanë ardhur diku rreth 200 të rinj për të mësuar shqip në Shqipëri. Prandaj, nuk është e vërtetë se shqiptarët nuk i duan shkollat, sepse të gjithë ata që po vijnë këndejpasi po tregojnë rezultate shumë të mira. Për të paralizuar këtë dukuri duhet dhënë këtyre mundësi më të gjëra që të shkojnë në shkollat tona, por ato duhet udhëzuar në mënyrë sistematike që shqiptarët të mos i kryejnë dhe, natyrisht të ndalohet shkuarja në Shqipëri. Mendojmë se kjo është forma më e sigurt për pengimin e tyre.<sup>27</sup>

Lëvizja kulturo-arsimore dhe kombëtare e shqiptarëve në Kosovë shfrytëzonte të gjitha metodat legale dhe ilegale nëpërmjet shoqatave humane të qytetarëve dhe të rinisë dhe se në plan kishte tërë terrenin ku banojnë shqiptarët. Arsimi dhe kultura shqiptare në Kosovë përhapej jo vetëm në ruajtjen e traditës, por rëndësi e posaçe i kushtohej edhe sjelljes së literaturës ilegale në gjubhën shqipe nga Shqipëria, e cila rreptësisht ishte e ndaluar.<sup>28</sup>

Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë, në anën tjetër, bënte propagandë që disa të rinj shqiptarë të tërhiqeshin në shkollim prej Shqipërie në Jugosllavi, në mënyrë që këta të ishin indikatorë se në Shqipëri shqiptarët gjoja s’kanë çka të lypin atje dhe gjoja se edhe ata po shkolloheshin në Jugosllavi, thuhet në disa raporte. Ardha e këtyre nxënësve nga Shqipëria në shkollat sllave ishte një dezorientim për masën e painformuar fshatare shqiptare. Por, në Kosovë disa intelektualë vepronin në mënyrë ilegale dhe zhvillonin aktivitet për mësimin e shkrimleximit. Në Mitrovicë veprimtari të tillë zhvillonte Shaban Idrizi.<sup>29</sup> Shabanin në këtë qytet shërbente si „mësues i fesë”, por në fakt ai fëmijët i mësonte në abetare pas mësimit legal fetar.<sup>30</sup> Shabanin, si duket, i kishte rënë në gjurmë policia dhe e ndiqte në hap aktivitetin e tij. Jo vetëm mësimi i shkrimleximit, por, për shembull, në Gjakovë Mustafë Cami dhe Ferid Mehmedi, që kryenin detyrën e mësuesit të fesë, ishin njëherësh bashkëpunëtorë të denjë të gazetës „Liria kombëtare”, që dilte në Gjenevë. Këta, po ashtu, jepnin informata bashkëpunëtorëve të „Federacionit ballkanik” si dhe patriotëve të tjerë udhëheqës të „Komitetit të Kosovës”.<sup>31</sup>

<sup>27</sup> AJ, s. 66, k. 57, d. pov. 607, d. pov. 4727.

<sup>28</sup> Punimi i lexuar në Kongres VII të historianëve të Jugosllavisë. Në Kosovë deportonin librat nga Shqipëria dhe lexoheshin me andje si „Libër këndimi, për shkollat fillore të Shqipërisë” për klasë të ndryshme të botuara në shtëpin botuese „Kristo Luarasi”. Në Kosovë lexohej „Patriotizmi dhe Nacionalizmi” e Kristo Floqit botuar në 1928. Libri „Atdheu e bota”, botuar në Tiranë më 1929, pastaj „shkenca fizike natyrore” botuar më 1928. „Kamuni i Lekë Dukagjinit” botuar më 1933 dhe gazeta si „Kosova” „Liria Kombëtare” e tjera. Gjurmët e këtyre librave i gjetëm nëpër Kosovë.

<sup>29</sup> AJ, s. 66, k. 57, d. pov. 2614. d. pov. 525, d. pov. 3748, d. pov. 620/25.

<sup>30</sup> AJ, s. 66, k. 57, d. pov. 10, d. pov. 626. d. pov. 182/25.

<sup>31</sup> AJ, s. 66, k. 57, d. pov. 606/27.

Duke vërejtur se shqiptarët, përkundër të gjitha presioneve, po shkolloheshin në shkollat e ndryshme në Shqipëri dhe gjetiu, Ministria e Punëve të Brendshme e Mbretërisë SKS me 19 gusht të vitit 1927 iu dërgoi të gjitha qarqeve në Kosovë një urdhëresë me këtë përmbajtje: 1. të gjithë të rinjtë shqiptarë që dëshirojnë të shkollohen jashtë, u ndalohet shkollimi jashtë Jugosllavisë si dhe marrja e bursës nga cilido shtet qoftë. Nëse ngjan që fëmijët të arrijnë të depërtojnë në shtetet e tjera për shkollim, thuhet aty, atëherë duhet të dënohen prindërit ose kujdestarët e tyre. 2. Të gjithë ata që shkojnë ilegalisht me shërbimet e veta me rastin e kryerjes së shkollës, nuk duhet të pranohen në punë nëse kthehen. 3. të gjithë ata që kthehen në Kosovë pas shkollimit duhet t'i dorëzojnë dokumentet se ku janë shkolluar". Nga kjo del se me çfarë rreziku e shikonte borgjezia serbomadhe në pushtet shkollimin e shqiptarëve si dhe zgjimin kombëtar të tyre.<sup>32</sup> Së këndejmi një vit më vonë Ministria e Punëve të Jashtme e Jugosllavisë thekson nevojën që përfaqësitë e saj të angazhohen më tepër për angazhimin e shqiptarëve nga Shqipëria në shkollim në gjuhën serbe në Serbi, në mënyrë që këta të përdoren pastaj për veprimtarinë informative antishqiptare. Këtyre, thuhet aty, duhet dhënë burës dhe duhet siguruar kushte të nevojshme. Por, posa të arrijnë duhet të fillohet puna me ta, në mënyrë që kur ta kryejnë shkollimin të dinin se ku qëndrojnë.<sup>33</sup>

Në vitet 20, organizatat ilegale „Agimi më seli në Gjakovë” ishte bartëse e shpërndarjes së librit shqip. Kishte një rrjetë të gjerë të shpërndarjes së literaturës. Ndërsa në vitet 30 bartësi kryesor i arsimit të rinisë shqiptare në Jugosllavi ishte, pa dyshim, organizata antifashiste përparimtare „Drita”, me seli në Drenicë.<sup>34</sup> Kjo dëshmon se, përkundër terrorit rinia shqiptare në forma të ndryshme e në mënyrë të vazhdueshme e donte shkrimleximin.

Duke vërejtur këtë, pushteti filloi të dyshonte në çdo gjë që ishte shqiptare dhe që e mbante këtë emër. Xhandarët dhe policët e shumë vuna pika dyshimi edhe në „mësimin e Kuranit dhe të Bibles”, sepse edhe ato, thuhej, nëse i mësojmë „këta shqiptarët fanatikë për të ruajtur idenë kombëtare”, do të bëhen të rrezikshëm për ne. Për të penguar këtë, Pushteti Sërbo-Kroato-Slllovene filloi të sillte nëpër medrese „mësues” nga Bosnja dhe Hercegovina, të cilët nuk dinin asnjë fjalë shqipe. Kështu filloi ndërrimi i mësuesve të fesë gati në të gjitha viset e Kosovës.<sup>35</sup> Po këtë tendencë të qarqeve borgjeze fashiste fëmijët shqiptarë filluan ta bojkotonin dhe kështu u mbyllën shumë të ashtuquajtura mejtepe në Kosovë. Ndërrimi i elementit kombëtar shqiptar nga pozita e mësuesve të islamizmit u përligj me Pragmatikun e Bashkësisë së Fesë Islame në Shkup, e cila si gjuhë zyrtare parashihte përdori-

<sup>32</sup> AJ, s. 66, k. 57, d. pov. 8278/27; Službene novine nr. 68. 19 sp. 1927 — dokumenti është i botuar në tërësi dhe se përfundon të „ndalohet shkollimi i shqiptarëve”.

<sup>33</sup> AJ, s. 66, k. 57, d. pov. 3884/28; d. pov. 311; d. pov. 5344/28.

<sup>34</sup> *Punimi i cituar*, i lexuar në Novi Sad në Simpozium.

<sup>35</sup> AJ, s. 74, k. 53, d. 37661, ndërrimi i Ibrahim Ibrahimit, *punim i cituar*.

min e gjuhës serbe, për të treguar lojalitet ndaj politikës shtetërore. Kjo dëshmon se në qarqet e rejzylejve, aty rreth viteve 30 në edhe më vonë, vepronin ata persona që i ishin shitur Pashiqit dhe oborrit mbretëror që nga viti 1921, kur pat filluar fushata e haptë kundër komunistëve dhe mësuesve shqiptarë,<sup>36</sup> në përgjithësi.

Meqë pushteti nuk arriti të paralizonte aktivitetin kombëtar të mësuesve të „fesë” nëpër medrese, atëherë filloi të ndalonte punën nëpër disa medrese, të cilat gjoja, nuk kishte kushte. Mirëpo, shkakun ishte aty se ende punonin mësuesit shqiptarë. Këtij aksioni të pushtetit populli iu përgjigj: „Aty ku nuk bën mos ngatërro, por hape frontin ku nuk ke kundërshtar”. Shembull konkret ishte ndalimi i veprimtarisë së medresës në Prishtinë. Por, me ndihmën e Bajram Ajvazit, mësuesi që punonte në Prishtinë, Mehmet Faik Efendia hapi medresën e ngjashme në Podujevë, ku ai i mësonte 25 të rinj në frymën nacionaliste, por, kuptohet, nuk mungonte edhe mësimi i fesë. Kjo shkollë, thuhet në raport, në Podujevë është hapur për propagandë. Për ta penguar veprimtarinë e kësaj shkolle ishte angazhuar edhe Zhupani i madh por me kotë. Në rrethin e Llapit gjithnjë e më tepër po depërtonte libri shqip i sjellë në forma të ndryshme nga Shqipëria. Në këtë drejtim zell të madhe sidomos në rini, tregonte Jahja Fusha,\* i cili ishte ndër të parët që përhap shkronjat shqip tek të rinjtë e kësaj ane.<sup>37</sup> Për të mësuar paradite mësim në shkollë me serbë dhe pasdite në turqisht, ishte e pakënaqur, prandaj edhe pati rezistencë aty ku fëmijët pengoheshin të shkonin në shkollë. Është për t'u theksuar se shkollla të këtilla ilegale u hapën edhe në Gjilan. Ja si i shkruan Ministrisë (një përcjellje këtyre rrethanave) arsimit, Drejtoratit Mbretëror të Banovinës: Ministria e arsimit ka të dhëna se në Smirë dhe Stubëll e Ulët punon shkolla shqipe, në të cilat hoxhollarët punojnë dhe se ato i mban Shqipëria.<sup>38</sup>

Lidhur me këtë pason përgjegjja se në këto vende, pas një kontrollimi sistematik, nuk ishte gjetur asnjë shkollë shqipe, si dhe hoxhollarët që japin mësim, që do të thotë se mësimi zhvillohej në ilegalitet të thellë dhe me ndërprerje të kohëpaskohshme. Kështu elementit shqiptar të Kosovës i është mohuar çdo e drejtë në pikëpamje të zhvillimit kulturor në gjuhën e të parëve. „Gjuha shqipe, e cila mësohej prej kohësh më të lashta në ato vise fsheftazi apo çiltazi, e sidomos prej Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878) e këndej, sotë është kryekëput e ndaluar. Tue lënë me një anë aktivitetin e zhvilluar prej shqiptarëve të Kosovës që prej konstitucionit otoman (1908), thuhet në një raport të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë, do të përmendim vetëm shkollat shqiptare që kanë funksionue në atë regjim nën rrethinat e okupatës austriake në luftën e madhe 1916—1918, sot nuk ekzistojnë më pse janë mbyllë nga autoritetet serbe: sinkolla e Ferizoviqit me mësues famullitarin katolik me 15 nxënës, shkolla e Zymit me

<sup>36</sup> *Po aty.*

\* Jahja Fusha më 1942—1943, bashkëpunoi me okupatorin. (AVIIB—N.A 135).

<sup>37</sup> AJ, s. 66, k. 63, d. pov. 401; d. pov. nr. 2.

<sup>38</sup> AJ, s. 66, k. 77, d. pov. 87. pov. 130. pov. 151. pov. 75. pov. 187.

mësues Pal Lumezin me 40 nxënës, shkolla e Jakovës me mësues I. Puka, Sali Morina, Niman Ferizi, Ferid Imami, Ibrahim Kolqiu, Ibrahim Fehmiu, Lush Ndoca e tjerë, me 840 nxënës. Shkollat ishin edhe në katundet Bec, Brodosan, Brovinë, Glllogjan, Irzniq, Junik, Ponošhec, Sermjan, Zhabë me nga secila 35—40 nxënës, shkolla e Mitrovicës me mësues të shumtë dhe që i kishte 160 nxënës, shkolla e Prishtinës me 90 nxënës, shkolla e Vuçiternës me mësues Haxhi Tafilin me 60 nxënës, shkolla e Pejës ku zhvillonin mësim Murat Jakova, Hajdar Shehu — Dulla, Abdulrahman Qavolli, Mulla Regjmeta me 256 nxënës. Shkolla në Pejë numër 2 me mësues Halit Kastratin, Shaqir Qavollin e Sejdi Pejanin me 125 nxënës, shkolla e Pejës numër 3 me mësues Shaban Kelmendin e Pal Lumezin me 232 nxënës, shkolla e femrave e Pejës e Gjurakovcit me mësues M. Blakqorin me 222 nxënës, shkolla e Rakoshit me 183 nxënës, shkolla e Baranit me mësues Gjevat Kelmendin me 176 nxënës, shkolla e Zllokuqanit me mësues Ndue Varfi më 186 nxënës, shkolla e Strelcit Adem Negjipi me 175 nxënës, shkolla e Istogut me mësues Osman Tarakun me 285 nxënës, shkolla e Budisalcit me 150 nxënës. Në këto anë vepronin edhe shkolla në Gusi dhe në Plavë. Të gjitha këto shkolla që kanë veprue rregullishtë disa që nga koha e Turqisë e disa më vonë janë mbyllë më 1919 posa që Kosova u pushtue prej ushtrive serbe. Shkolla e komunitetit katolik të Jakovës, Pejës, Prizrenit janë mbyllë më vonë në vitin 1923 ndërsa ajo e Shkupit më 1929. Shumë prej mësuesve që kanë zhvilluar mësim në këto shkolla janë likuiduar në mënyra mizore” përfundon raporti.

Lidhur me qëndrimin armiqësor të pushtetit ndaj popullsisë shqiptare në disa raste në mënyrë të rreptë protestoi Hasan Prishtina në Shoqatën e kombeve në Gjenevë. Hasani thekson se prej 1 milioni shqiptar qeveria Jugosllave nuk ka hapur asnjë shkollë në gjuhën shqipe. Kjo tregon, thuhet në proteste, se qeveria e Mbretërisë SKS dëshiron për të asgjësuar kulturën e tyre dhe, shqiptarët në Jugosllavi në përgjithësi.<sup>39</sup>

Nëse rinia shqiptare në Jugosllavi, thotë Hasan Prishtina, nuk ka mundësi për tu shkolluar në gjuhën amtare, atëherë për ardhmërinë e saj janë vetëm dy mundësi: anacionalizmi ose për të hequr dorë nga çdo edukim dhe arsimim. Këto eventualitete janë të dhimbshme dhe fatëzeza për kombin tim që këso pozite nuk ka shembull në Evropë,<sup>40</sup> përfundon ai.

Lidhur me këtë akuzë Ministria e Punëve të Jashtme e Mbretërisë Jugosllave jep këtë arsyetim, më 1930 (2 janar), pas Peticionit të dytë të Hasan Prishtinës, më 1929: Në regjionin ku banojnë shqiptarët në Jugosllavi, thuhet në raportin që ia dërguan përfaqësuesit jugosllavë Shoqatës së kombeve në Gjenevë, kurrë nuk ka pasur shkolla shqipe (çka ishin ato të viteve 1916—1918). Kur i mori ato anë deri më inkorporimin e tyre në Jugosllavi ishin, gjoja, viset më të prapambetura në Evropë, pa komunikacion, pa si-

<sup>39</sup> DASIP, DNŽ, s. 89, f. 15, d. II, d. pov. 339; A.Q.H. RASSH, Ministria e punëve të jashtme, fotokopjen e mban autori.

<sup>40</sup> Po aty.

gurim shtetëror (sigurimi shtetëror u sigurua që të lidhen me mijëra familje shqiptare me tel dhe të vriten sikur që gjuhet në ujt e tërbuar —),\* pa kushte sanitare pa themelata kulturore, pa institucione ekonomike dhe arsimore, që te ajo popullatë s'ka kurrë interesim për shkolla dhe se nuk ka ndie kurrfarë nevoje për këtë. Nuk ka pasur kurrfarë gazetash as në gjuhën shqipe të shkruar. Kështu arsyetohet përfaqësuesi jugosllav, se gjoja në këto anë Jugosllavia paska vendosur rend dhe qetësi dhe se Mbretëria Jugosllave po bënte përpjekje mbinjerëzore për përhapjen e kulturës në këtë anë. Në këtë anë të Serbisë Jugore thuhet se vepronë 1401 shkolla me 2609 paralele. Prej tyre në 261 shkollë janë 545 klasë të ndara, ku i vijnë mësimet vetëm shqiptarët. Nga shifra e cekur, 18,62 për qind të shkollave dhe 20,88 për qind të klasave janë ku i vijnë fëmijët shqiptarë, ndërsa vetëm në vitin 1927 — 1928 në shkollat fillore ishin 7565 nxënës, prej tyre 7333 meshkuj dhe 232 femra. Shkollat janë në gjuhën serbokroate dhe se shkollë shqipe askush prej andej nuk ka kërkuar, pasi nuk kanë mësues. Atje ku ka shqiptarë myslimanë në këtë kohë (1930) vepronë 564 mësues feje shqiptarë, ndërsa prej tyre 475 që paguheshin nga buxhetet shtetërore. Përpos këtyre, janë edhe 310 nëpunës feje dhe mësimdhënës që paguheshin prej buxhetit shtetëror. Në raport thuhet se në Shkup është hapur „Medresja e Madhe”, ku fëmijët shqiptarë përgatiten për mësim në gjuhën amtare. Së fundi, në Universitetin e Beogradit është hapur „Instituti Albanologjik”, i cili jep revistën „Arhiv za arbanasku starinu, jezik i etnologiju”. Lidhur me këtë, kur të krijohen kushtet për hapjen e shkollave, atëherë do të hapen edhe në gjuhën shqipe,<sup>41</sup> përfundon raportin.

Tërë kjo që u tha më lart mund të ishte problem diskutimi në çfarëdo niveli, por një gjë dihet, sikur xhandarmëria të dinte se në cilindo katund të Kosovës gjendej ndonjë abetare në gjuhën shqipe, do ta digjte tërë fshatin.<sup>42</sup> Në peticionin që ia dërgonin Shoqatës së kombeve më 5 maj 1930, tre priftër shqiptarë, thuhet se qeveria Jugosllave e ka ndaluar çdo shkollë shqipe si dhe ka ndaluar përdorimin e shqipes në çdo vend publik, se jeta e shqiptarëve gjithmonë është në pikëpyetje. Se shqiptarët nuk kanë kurrfarë lirie se ato po privohen nga e drejta e pronës dhe se kurrfarë pune intelektuale për shqiptarë nuk është e lejuar, se ishin dalluar shoqatat kulturore shqiptare me karakter muzikor në Gjakovë, Pejë, Prizren, Shkup dhe gjetiu. Për shqiptarët thuhet, në peticion është e ndaluar edhe predikimi i fesë në gjuhën shqipe. Se qarqet jugosllave i kishin mbyllur shkollat shqipe që punonin në shumë vise të Kosovës më së miri dëshmonë fakti se shumica e mësuesve ku vepronin ato tanimë janë likuiduar. Nënshkruesit e Peticionit i numërojnë pastaj shkollat që ishin mbyllur, japin nu-

\* Shiqo Gjorgj Kriste, *Kolonizacija, J. Srbija...* f. 51—52. mikrofilm „K. Kosovës” 1918—21.

<sup>41</sup> DASIP DNŽ, s. 39, f. 1, d. 2, d. pov. 10—16872; Shiqo po aty f. 5. d. 16. pov. 343. pov. 250”...

<sup>42</sup> AVIIB, p. 17. k. 27, f. 1, d. 20; DASIP, d. n. ž. f. 15, d. 1. frengjisht *La situation de la minarita Albanois en Yugoslavie* 5. v. 1930.

mrin e nxënësve dhe emrat e mësuesve që, si duket, prej tyre i pat marrë Ministria e Punëve të Jashtme e Shqipërisë.

Nga kjo del se Jugosllavia borgjeze jo vetëm që kishte shuar dhe po shuante çdo tendencë të zhvillimit kulturor, por synonte edhe asimilimin e plotë të shqiptarëve duke pasur objekt sulmi kulturën e tyre, traditën, adetet dhe zakonet. Dhe, derisa ky shtet me regjim profashist i kishte mbyllur shkollat ku vijonin mësimet edhe nga 60 nxënës, në Shqipëri mbaheshin klasat për serbë, si për shembull, në Shkodër, klasa e parë me 14 nxënës, klasa e dytë me 21 nxënës, klasa e tretë me 15 nxënës, klasa e katërt me 7 nxënës. Shqipëria e Zogollit për fëmijët sllavë kishte hapur edhe foshnjore. Ku ishin vendosur 16 fëmijë paralelja e quajtur e vjetër me 14 vijues, si dhe një shkollë për punëtorë më 11 nxënës sllav.<sup>43</sup> Jo vetëm për këtë, por Qeveria Jugosllave interesohej nëpërmjet shtypit dhe agjenturave të ndryshme që kisha ortodokse të ishte në pozitë të favorizuar, ndërsa nëpër Kosovë rrëzoheshin të gjitha përmendoret që kishin të bënin me kulturën materiale të shqiptarëve, si xhamia, teqe, dervishësh e shehlerësh, të cilat më 1920—1921 ishin shndërruar në punkte për zgjerimin e fjalës së Partisë Komuniste, posaçërisht në Gjakovë, Prizren e Rahovec. Rrezoheshin medrese dhe shkolla e të mos flasim për kulla, të cilat kishin shërbyer më parë për lidhje besash kundër pushtuesve osmanlinj.<sup>44</sup>

Meqë ishin ndaluar shumica e medreseve dhe e shkollave ku ishin të pranishëm shqiptarët, kleri shqiptar bëri përpjekje që nëpër disa vende të organizonte të ashtuquajturat „sibijan mektebi”, si në Vuçitërnë, Mitrovicë, Prishtinë, e vende të tjera. Nga një raport i Drejtoratit të Banovinës së Zetës mësojmë se edhe kjo formë e shkollimit duhej të pezullohej, sepse këto shkolla, thuhet aty, janë të dëmshme. Nga kjo del se nëpërmjet raportit të dërguar më 1930 Shoqatës së kombeve nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Mbretërisë Jugosllave gënjehej opinioni botëror, se për shkollë shqipe gjoja nuk kishte mësues dhe se në të ardhmen kjo do ishte realitet. Përkundrazi, pas 10 vjetësh në të gjitha raportet zyrtare jo vetëm nuk flitet për shkollë shqipe, por jipte urdhra të ndalohen edhe ato medrese mësim fetar. Më 1931 tërë Gjakova qe bllokuar dhe malltretuar vetëm pse ishte gjetur një femër që quhej Gjyle Halil Spahija e që vullnetarisht ua mësonte nja 80 femrave shkrimleximin. Së këndejmi me që të gjithë nxënësit në fshehtësi mbanin abetare në ilegalitet dhe meqë edhe çështja kombëtare dhe ajo fetare e shqiptarëve në Kosovë „është në këmbë të qelqta” nga „presioni i jonë” thuhet në dokumentet e qarqeve në pushtet, edhe më duhet të rrisin zullumin kundër tyre,<sup>45</sup> përfundon raportuesi. Mësuesja Gjyle Halil Spahija qe mall-

<sup>43</sup> Shiqo AJ, s. 66, k. 7. d. pov. 14249; pov. 22795/30.

<sup>44</sup> AJ, s. 74, k. 3/10. delatnost albanske crkve.

<sup>45</sup> AJ, s. 66, k. 105, d. pov. 499; d. pov. 366; d. pov. 43; d. pov. 45; d. pov. 96; d. pov. 46; d. pov. 145; d. pov. 313; d. 2137. Lita „Sibijan Mektebi” dhe urdhri për ndalimin e tyre; AJ, s. 66, k. 22, d. pov. 418 „në shqiptarë tek nxënësit e mësimi fetarë po thuhet se shteti ëmë është Shqipëria se mbreti shqiptar është Zogu-kjo është e rezikshme”. Shiko d. pov. 485; Shiko, aty,

tretuar, edhe pse mësimin e mbante në shtëpinë e vet më tepër në baza fetare, por edhe vijuesve të saj disa herë në javë u mësonte alfabetin shqip. Kështu për shqiptar ishte i ndaluar edhe formimi i shoqërive kulturore e sportive. Në Kosovë nuk kishte teatro, nuk lejohej përdorimi i simboleve kombëtare, ndalohej çdo zhvillim kulturor. Edhe këngët popullore këndoheshin në mënyrë ilegale nëpër ndeja dhe dasma. Por Oda po e ruante karakterin përcjellës ideo-politik kombtar. Aty klasorja dhe kombëtarja nuk kishin primat.

### 3. Friga e qeverisë prej ngritjes kulturo-arsimore të shqiptarëve

Qeveria borgjeze e Jugosllavisë pati problem në fillim (1918 e derimë 1928) me Lëvizjen Kombëtare Shqiptare me armë e cila ishte shkolla më e avansuar për atë kohë për fitoren e lirisë e udhëhequr nga Bajram Curri, Hasan Prishtina, Azem Bejta e shumë të tjerë. Në pashitjen e kësaj lëvizjeje në një masë pushteti borgjez nuk lejonte hapjen e shkollave shqipe, sepse në të llogaritime realizatorin më të „rrezikshëm” të të drejtave të shqiptarëve. Në të vërtet, kjo frikë e borgjezisë nuk ishte e pavend, por „frika” nuk ishte vetëm nga arsimimi, por nga e tërë popullsia. Nga ky problem, i cili u theksua disa herë në „Srbski kulturni klub”, si dhe në nivel ministrish, doli kërkesa për të bërë konventa ndërkombëtare, për ta azgjësuar këtë popullatë. Deri më 1925, thuhet në raporte, problemet kryesore pushteti ia krijonte organizata „Bashkimi”. Me presion në këtë parti mendohej se do të arrihej qëllimi i caktuar. Mirëpo, pasi kjo nuk dha rezultate, filloi të zbatohej metoda që secili anëtar t'i lihej minimumi i pronës dhe kështu të vështirësohej ekzistenca dhe askush të mos e kishte jetën e sigurt. Por, çfarë u bë në të gjitha vendet ku jetojnë shqiptarët, pyesin raportuesit, ka shkolla popullore dhe se shkollimi në to është i obliguar tërësisht në gjuhën serbokroate. Përpos këtyre shkollave, shqiptarët kanë edhe shkollat e tyre fetare, të cilat zhvillojnë vepërimtari tjetër. Në këtë drejtim posaçërisht druajnë politikanët borgjezë të Mbretërisë Jugosllave, nën aktivitetin në dobi të popullsisë shqiptare që kishte zënë të zhvillohej në Medresën e madhe në Shkup.<sup>46</sup>

Kërkesat për themelimin e medresës në Shkup i gjejmë qysh më 1922. Lidhur me këtë në një projekt ideor dërguar Këshillit kryesor të arsimit më 15 tetor të vitit 1923 mësojmë se: „Shkolla e tillë duhet të jetë një lloj akademie e myslimanëve në rang të shkollës së mesme, ku qëllimi edukativ do të jetë ngritje e vetëdijes shtetërore te nxënësit. Te ata duhet të zgjohet interesimi për përkatësinë shtetërore, ku nuk do të prezantohet gjuha shqipe. Nxënësit duhet të kishin parasysh sidomos „bamireshinë” e mbre-

raport në lidhje me shkollën e Gjyle Halilit plakë 82 vjeçare, e cila që malltretuar nga inspektori i shkollave një muaj të tërë, por plaka qëndroi heroikisht, nuk pranoi se ka mbajtur në shkollë abetare — Gjakovë.

<sup>46</sup> AVIIB, p. 17, k. 94, f. 1. d. 16.



tit Aleksandër, prandaj edhe shkolla mori emrin e tij.<sup>47</sup> Megjithatë, medresja u themelua më 1925 dhe zhvilloi një aktivitet të rëndësishëm kulturo-arsimor jo vetëm në Shkup, ku e kishte selinë, por edhe në tërë Kosovën dhe më gjerë.<sup>48</sup>

Sipas një ankese të njërit ndër themeluesit e kësaj shkolle, Hafuz Abdyl Hagji Husmanit, në lidhje me mallverzimet nga ana e drejtorit të internatit, qëllimi i Pashiqit nuk ishte arritur. Pashiqi, thuhet aty, këtë institucion e ka menduar për qëllim politikopsikologjik në sytë e botës islame, por është arritur efekti i kundërt, se edukimi këtu nuk bëhet në suaza të kompetencave që i ka.<sup>49</sup>

Medresa e Shkupit në vitet 1925—1926 e kishte vetëm një paralele me 58 nxënës. Në vitin 1926—1927 në shkollë vepronin 7 arsimtarë me 97 nxënës, ndërsa në vitin shkollor 1927/28 vepronin 8 arsimtarë me 130 nxënës. Në vitin shkollor 1928/29 vepronin 10 arsimtarë me 180 nxënës, në vitin shkollor 1929/30 vepronin 12 arsimtarë me 195 nxënës. Me 1930/31 vepronin 14 arsimtarë me 196 nxënës, në vitin 1931/32 15 arsimtarë me 214 nxënës, në vitin shkollor 1932/33 17 arsimtarë me 224 nxënës, në vitin shkollor 1933/34 20 arsimtarë me 228 nxënës, në vitin shkollor 1934/35 vepronin 19 arsimtarë me 213 nxënës, në vitin shkollor 1935/36 vepronin 19 arsimtarë me 240 nxënës, në vitin shkollor 1936/37 vepronin 21 arsimtarë me 230 nxënës. Shenimet për numrin e arsimtarëve dhe të nxënësve prej vitit 1938 1940 nuk arrijtëm të i gjejmë. Në këtë shkollë që ishte 8 klasëshe që nga viti shkollor 1932—1933 dualën kuadrat e para e që shumica prej tyre nuk u orientua në profesione fetare.<sup>50</sup>

Orientimi në shkolla të tilla fetare, thuhet në raporte, është treguar shumë i rrezikshëm, sepse hoxhollarët gjoja „janë bartësit më të rrezikshëm të arsimit të shqiptarëve”. Ndërsa prania e shqiptarëve në gjimnaze ishte e rrallë por në kohën e fundit sikur janë zgjuar nga gjumi. Të rinjtë shqiptarë po bëjnë invazion nëpër gjimnaze me qëllim që të sigurohet kuadër i fortë kombëtar. Në anën tjetër, Medresja e Shkupit tani sa vjet për çdo vit i qet nga 20 kuadra dhe gati të gjithë po regjistrohen në fakultete. Në këtë vit (raport i vitit 1938), një pjesë e madhe e shqiptarëve është regjistruar dhe ka marrë indeksin e fakultetit. Komentatorët ushtarakë pyesin se çfarë do të bëjnë ata kur t'i kryejnë këto shkolla Qarçet në pushtet theksoin se ky element do jetë shumë i rrezikshëm për shtetin tonë, prandaj droja prej tyre duhet të jetë e arsyeshme dhe se me çdo kusht atyre duhet bërë të pamundshëm shkollimin për të cilin janë shumë të interesuar.<sup>51</sup>

Mësimi dhe edukimi i shqiptarëve, tani më 1938, ishte edhe më i organizuar se kurrë më parë, sepse prej Shqipërie po i ndihmohej rinisë në forma të ndryshme, ndërsa nuk ishte i vogël numri i

<sup>47</sup> AJ. s. 63. k. 137, d. glavnom prosvetnom savetu, pa numër.

<sup>48</sup> AVIIB, p. 17, k. 94, f. 1. d. 16. AJ, s. 63, k. 137 — 1—29. Sekret.

<sup>49</sup> AJ. s. 66, d. 7. V. 1929.

<sup>50</sup> Spomenica 25, osl. j. Srbije f. 947.

<sup>51</sup> AVIIB, p. 17, k. 94, f. 1, d. 16. k. 92, f. 1, d. 12.

fëmijëve shqiptarë nga Kosova që shkolloheshin në Shqipëri dhe se atje edukimin e merrnin në „frymën nacionaliste” kuptohet se diç e tillë ishte e pranishme.<sup>52</sup>

Qeveria e Millan Stojadinoviçit kishte bërë një listë të shqiptarëve të „rrezikshëm”, të cilët, sipas saj, po „mundoheshin nga Shqipëria për të përhapur nacionalizmin shqiptar në Kosovë”. Në këtë drejtim, thuhet në raporte, aktivitet të dukshëm po zhvillonte konsullata shqiptare në Shkup, e cila gjithmonë ishte në kontakt me Drejtoratin e vakufëve në Shkup si dhe me udhëheqësinë e saj Ferat Dragën, për t’u dhënë bursë nxënësve shqiptarë. Fjalën kryesore për përhapjen e nacionalizmit shqiptar, theksojnë raportet sekrete ushtarake, e ka Ferat Draga, i cili patjetër duhet të ndërrohet nga ky post ose me kompromitim ose me inicimë në Këshill, ku pas përçarjes ai do mënjanohej nga ndikimi në politikën e shkollimit, sepse fondi i vakufit në Shkup ishte shumë i pasur për dhënien e bursave fëmijëve shqiptarë. Ferat Draga është në krye të vakufëve dhe faktikisht mund të thuhet se është ilegalizuar aktiviteti i partisë „Bashkimi”. Është e mjaftë të përmenden emrat e këtyre studentëve që përpiluan një proklamata drejtuar popullsisë në Kosovë. Të gjithë përpiluesit janë të kombësisë shqiptare dhe e thërrasin popullin shqiptar që të qëndrojë para çdo presioni, Përpiluesit thuhet në raporte, janë Tahir Ismajli, Gjevdet Pallaska, Hajdar Pashë Abdyrrahmani, Est Shahoviçi. Propogandë të gjerë bënë edhe këta studentë: Qamil Ibrahim, Negjdet Basha, Zhara Hyzir, Ahmet Mehmedi, Esat Mekuli, Numan Regjepi, Metë Bajraktari, Hasan Haki, Zejnel Hajdini — të gjithë këta marrin bursa prej drejtoratit të vakufëve dhe se numri i tyre së shpejti do të jetë mbi 100. Në këtë drejtim ku ideja kombëtare është vënë mbi të gjitha,<sup>53</sup> përfundojnë raportet.

#### 4. Shkollat legale shtetërore në Kosovë

Sa i takon çështjes së shkollave fillore në Jugosllavinë borjeze, ato u hapën në gjuhën sërbo-kroate në të gjitha rrethet dhe nëpër ato komune ku borgjezia kishte interesa kombëtare. Kjo do thotë se hapja e shkollave u bë në rend të parë nëpër qytete dhe nëpër lokalitete ku pjesa më e madhe e popullsisë ishte e etnikonit sllav.

Çështjen e shkollimit borgjezia serbomadhe që në fillim të jetës së shtetit SKS nuk ishte e aftë ose nuk dëshironte ta rregullonte në të gjitha viset e Kosovës. Në përgjithësi, shkollat fillore ishin 4 klasëshe, kështu që në vitin shkollor 1939—1940 në Kosovë

<sup>52</sup> AVIIB, p. 17, k. 26, f. 3, d. 24 — Rasturanje albanskih bukvara po Me-tohiji; AJ, s. 66, k. 7, d. 2253, shkollimi dhe gazetat shqipe në Rumuni dhe bartja e tyre në Kosovë.

<sup>53</sup> AJ, s. 66, k. 7 — plani i shqiptarëve të shkolluem dhe politika arsimore e propagandës shqiptare; AJ, s. 63, k. 171, pov. 15813, d. pov. 42554; d. pov. 34317. Më 1940 Ferat Draga qe kompromituar nga pushteti për të ndaluar shkollimin e shqiptarëve që ai të mos u jepë bursa. (Fer at Draga më 1941—1944 bashkëpunoi me okupatorin).

vepronin 250 shkolla me 654 paralele, në të cilat mësonin 26894 nxënës të gjinisë meshkullore dhe 10611 nxënës të gjinisë femrore me gjithsej 37505 nxënës. Në këto shkolla jepnin mësim 506 mësimdhënës meshkuj dhe 222 mësimdhënës femra.<sup>54</sup> Nga kjo del se vetëm 30,2 për qind të fëmijëve vijonin mësimin fillor, se nxënës të gjinisë femrore prej moshës 7 deri në 15 vjeç ishin 57,80, ndërsa mësimet i vijonin vetëm 18,4 për qind e numrit të përgjithshëm. Se në një paralele që ekzistonte vinin 190,1 nxënës që duhej të shkolloheshin, se çdo i 17-ti banor ishte nxënës i shkollës fillore. E tërë kjo dëshmon për prapambetjen kulturo-arsimore të kësaj ane.<sup>55</sup> Por, kur t'i shtohet kësaj se numri i nxënësve shqiptarë nëpër këto shkolla ishte shumë i vogël, atëherë del se gjendja ishte edhe më e mjerueshme.

Gjatë vitit shkollor 1918—1919 në Kosovë filluan punën 3 gjimnaze: në Prishtinë, Prizren dhe në Pejë. Gjatë vitit shkollor 1919—1920 u themeluan edhe dy gjimnaze, në Mitrovicë dhe në Gjiçan, ndërsa në vitin shkollor 1920—1921 gjimnazi i Prishtinës u bë gjimnaz i plotë, ndërsa një vit më vonë edhe ai i Pejës. Në vitin shkollor 1924—1925 u themelua edhe gjimnazi jo i plotë në Ferizaj, ndërsa po në këtë vit gjimnazi i Prizrenit u bë shkollë e plotë.<sup>56</sup>

Me Ligjin mbi shkollat e mesme më 1929 u shkrin gjimnazet në Gjiçan, Gjakovë dhe Ferizaj dhe se në këtë drejtim edhe gjimnazi i Pejës kaloi në gjimnaz jo të plotë.<sup>57</sup> Por, gjatë vitit shkollor 1929—1930 qarqet në pushtet sërish e ndërruan politikën arsimore dhe gjimnazet e plota u lejuan të vazhdonin punën në Prishtinë, Prizren, Pejë dhe në Mitrovicë. Më 1932—1933 gjimnazi i Pejës u bë i pavarur, më 1933—1934 gjimnazi i Mitrovicës kaloi në rang jo të plotë, ndërsa gjimnazi i Pejës në vitin shkollor 1935—1936 u kthye në gjimnaz të plotë shtetëror. Numri i nxënësve në këto shkolla kurrë nuk ishte përkatës me strukturën e popullsisë.<sup>58</sup>

Kur kihet parasysh se nga numri i përgjithshëm i nxënësve të përfshirë në shkollim, shqiptar ishin 1,4 për qind, ndërsa 96 për qind Jugosllav e të tjerë, dhe kur t'i shtohet kësaj se në Kosovë për afërsisht 15, deri 16 për qind e popullsisë dinte shkrimlexim, atëherë bëhet edhe më e qartë e tërë pesha skllavëruese e masave të shtypura dhe të shfrytëzuara. Nga aspekti i strukturës sociale, 93 për qind të femrave ishin analfabete, por nëse merret parasysh numri i femrave shqiptare, atëherë përqindja është shumë më e madhe. Analfabetizmi tek shqiptarët në Jugosllavinë e vjetër kurrë nuk ra nën 98,5 për qind e në disa raste, sidomos në rrethin e Gjiçanit, të Llapit, Mitrovicës, Vuçitërnës, Graçanicës, Drenicës, Istogut, Ferizajt, Suharekës, Rahovecit e të Dragashit arrinte deri 99 për qind.<sup>59</sup>

<sup>54</sup> Dr. Svetozar Čanović, *Specifični problemi nastave u škola-ma Kosova i Metohije*, Prishtinë 1967, f. 79.

<sup>55</sup> *Po aty*.

<sup>56</sup> *Spomenica 25 godišnice...* f. 933—934.

<sup>57</sup> *Po aty*, f. 935.

<sup>58</sup> *Po aty*, f. 936. Svetozar Čanović, *Specifičnosti...* t. 82.

<sup>59</sup> *Po aty*, f. 937; S. Čanović, *v. cit.* f. 83; AVIIB, p. 17, k. 26, f. 3. d. 5.

## 5. Qëndrimi i mësuesve ndaj nxënësve shqiptarë që vijonin shkollën në gjuhën serbe

Në Gjimnazin e Prizrenit, ku ishin rreth 800 nxënës e ku shumica e popullsisë ishte shqiptare, numri i nxënësve shqiptarë që mësonin në gjuhën serbe mezi arrinte në 74 nxënës. Në gjimnazin e Pejës gjithashtu ishin vetëm 30 nxënës shqiptarë, ndërsa numri i nxënësve në përgjithësi në këtë gjimnaz arrinte mbi 800. Gjendja ishte e njejtë në Gjakovë, Mitrovicë, Prishtinë, Gjilan, Ferizaj, Vuçitërnë e në vise të tjera. „Duke përjashtuar shqiptarët nga zhvillimi mendor ndër shkolla, duke përdorur të gjitha mjetet për varfërimin material e shpirtëror të tyre u përgatit me vite sheshi psikologjik për t'ua mbushur mendjen masave shqiptare se mundësia e zhvillimit intelektual të tyre ishte e kufizuar. Shqiptarëve u thuhej se gjuha shqipe nuk ishte në gjendje t'i plotësonte konditat që kërkoheshin prej një gjuhe kulturore”.<sup>60</sup> Shqiptarët, thuhet fëmijëve, janë vetëm për hamall nëpër qytete, se këta nuk janë në gjendje të bëhen mjekë, gjyqtarë, avokat, inxhinirë, profesorë apo mësues.<sup>61</sup> Nxënësve shqiptarë u ndalohej edhe këndimi i këngëve popullore që flitnin për trimërin dhe lavdin e popullit.

Para nxënësve shqiptarë për pushtetin SKS<sup>62</sup> recitoheshin poema, heroizmi, buqitnin lahutat shurdhuese, ndërsa për shqiptarin kosovar paraqiteshin teza të mëkatarit, ngriheshin në kup të qiellit mallkimet dhe përbuzjet dhunuese. Për mësuesit shovinistë të edukatës së Pashiqit, të rritur e të gatuar me frymëzime e parime që lartësonin instiktet më të ulta të psikologjisë së njeriut të ngritur në dogmë fetare — kombëtare, mund të quhej me të drejtë „vepër qytetërimi” zhdukja e shqiptarëve nga faqja e dheut. Fjalët *vrasje, terrorizëm, skllavërim dhe martirizim* ishin konceptë të zbrazëta për mendjen e atyre mësuesve të çmendur nga ëndërrimet. Në këtë drejtim kryetari i „famshëm” i panserbizmit drejtonte nga qendra orkestrin ideologjik të Serbisë së madhe, ndërsa mësuesit fanatikë me aftësi e mjeshtëri agjentësh, e përdornin mjetet më të ndyra brenda mureve të shkollës. Jashtë xhandari zbatonte me flakë e pushkë urdhërat dhe në skutat më të fshefta të Kosovës duke vrarë dhe malltretuar, ku, sipas shënimeve sekrete shtetërore, 80 mijë shqiptarë gjatë 23 vjetëve të këtij regjimi ishin likuiduar e përsekutuar ndërsa shumica dërmuese e tyre ishte e moshës rinore. Pra, jo vetëm në popull, por edhe fëmijëve u thuhej nëpër shkolla se „unë jamë ujk e ti je qingj”.<sup>62</sup>

Lidhur me këtë në një raport të inspektorit të shkollave të rrethit të Mitrovicës dërguar me shifër sekrete ministrit të arsimit thuhet se mësuesit po i malltretojnë fizikisht dhe psikikisht fëmijët shqiptarë. Ata po shkojnë të përgjakur nëpër shtëpi në mënyrë që më të mos i vijnë mësimet. Por, pyet raportuesi, „vallë, a janë fëmijët kaçakë, ata nuk kanë kurrfarë faji”.<sup>63</sup>

<sup>60</sup> „Kosova”, nr 10/41; Z. Rexha, *Kosovari në Shkollën e Mbretërisë SKS*.

<sup>61</sup> „Kosova”, nr. 10, 4 korrik 1941, një ish-nxënës në shkollën serbe.

<sup>62</sup> Zekerija Rexha, *Kosovari në shkollën e Mbretërisë SKS*.

<sup>63</sup> AJ, m. prosvete, pov. od. 66, k. 59. d. pov. 169.

Lidhur me këtë naçallniku i kësaj ane kishte këshilluar fshatarët e fshatit Zhabar që të ankoheshin të ministri i arsimit për malltretimet e këtilla të fëmijëve të tyre, por ai kishte marrë përgjigje se Shqiptarët nuk guxojnë të ankohen, meqë derisa të dëgjojë ministri, ne mund t'i shfarosim që të gjithë.<sup>64</sup> Nuk duhet harruar se kishte edhe mësues të ndershëm, por të tillë pushteti borgjez në Kosovë nuk i lejonte të vazhdonin karrierën dhe nëse vërehej se mësuesi kishte qëndrim të drejtë ndaj të gjithë fëmijëve, ai, për tu larguar nga vendi i punës, menjëherë akuzohej si bolshevik.<sup>65</sup>

Në shkollën shtetnore ndërmjet dy luftrave, theksojnë raportet, fëmijët shqiptarë nuk ishin asgjë tjetër vetëm „mangup”, „pogan”, „turqin”. Fëmija shqiptar i fesë katolike, latin, të rdytë e të tjera. I pari duhej të shkonte në Anadoll, ndërsa i dyti te Papa i Romës, edhe pse kishin gjak e gjuhë të përbashkët shqiptari. Shqiptarët predikonte mësuesi shovinist në shkolla, thuhet në raportet e ish nxënësve konsideroheshin të pabesë, trathtarë, të paaftë të kuptonin diturinë dhe kulturën, njerëz të egër, ndërsa fëmijët tjerë stërnipa të Dushanit, Miloshit, Milanit, e të Milicës, „bij heronjsh të larë me gjak sulltanësh e princash, pikur nga qielli për t'i qytetruar të paktën racat e popujve bastardhë të Ballkanit”. Shqiptarët, sipas këtyre mësuesve, gjoja ishin primitivë, njerëz me bishta, me racë e me fuqi materiale të shkallës së ultë njerëzore, ndërsa sllavët fisnikë nga gjaku dhe të shkëlquar nga mendja dhe se i kishin të gjitha tagrat e njerëzve të qytetëruar, ndërsa shqiptarët të paaftë kurrjë vetëm mund të fshinin, thoshin mësuesit nëpër klasë, këpucë e rrugë, të punonin tokën e grabitur nga kolonistët dhe të jen shërbëtorë të mirë. „Edhe zoti, thuhej nga mësuesit e flet gjuhën tonë”. Zotërimi i këtyre predikime, theksoin raportet, nuk donte ndonjë aftësi të madhe pedagogjike, kulturore. Këto shprehje me të cilat shërbehej borgjezia serbomadhe e që reflektoheshin para nxënësve mund t'i belbëzonte çdo mësues më lehtësi. Sipas predikimit të mësuesve, shqiptarët e Kosovës nuk kishin nevojë për gjuhë, se mjaftonte arabishtja e xhamisë, skishin nevojë për ligje civile e kombësi, sepse gjoja mjaftonin normat e kuranit. Kjo botë, sipas tyre, u takonte vetëm të zgjedhurve, ndërsa shqiptarët duhej të përpiqeshin për atë botën tjetër. Dhe, në këtë drejtim në shkollë shqiptarëve u ndalohej të flitnin shqip, u ndalohej të banin kësullë të bardhë, si dhe e kishin rreptësisht të ndaluar për të pasur në rroba ndonjë simbol të kulturës kombëtare.<sup>66</sup>

Së fundi të perfundojmë me një mendim të Shtjefën Gjeqovit se populli arsimohet vet edhe kur e ka të ndaluar.

<sup>64</sup> *Po aty*, D. pov. nr. 2; d. pov. 270, mësuesi përdor para fëmijëve shqiptarë shprehje të padëshiruara dhe i rrah fëmijët si të ishin të burgosur.

<sup>65</sup> *AJ*, s. 66, k. 52, d. pov. 7; d. pov. 471; d. pov. 461; d. 22368; d. 3. d. 8, d. pov. 18, s. 66, pov. 386, k. 13, pov. 105. pov. 323. s. 74, k. 56. Lutje mbretit, mjafton të të thuhet se familja ime ka likuiduar këtë apo atë shqiptar e që fëmijëve të tyre t'u sigurohet shkollimi — dokument sekret.

<sup>66</sup> *Zekerija Rexha, punimi i cituar*.

L'ATTITUDE DE LA YUGOSLAVIE MONARCHISTE RELATIVE  
A L'ENSEIGNEMENT ET A LA CULTURE DES ALBANAIS  
EN KOSOË (1918 A 1941)

R é s u m é

Les efforts séculaires des Albanais concernant l'ouverture des écoles furent toujours empêchés jusqu' en 1945, par la classe dominante. Ces efforts se rendent évidents récemment. C'est vrai que les occupants faisaient tout le possible pour que les Albanais soient et restent un élément dénational, lié à des centres confessionnels et religieux. Les patriotes faisaient beaucoup d'efforts que parallèlement aux écoles religieuses s'infiltraient l'enseignement national car les Albanais différenciaient l'idée: religion et nation. Une telle lutte fut bien comprise par l'occupant, c'est pourquoi, il luttait par tous ses moyens d'empêcher toute communication linguistique albanaise: écrite — lecture.

Dans la ex — Yougoslavie monarchiste, le gouvernement faisait des efforts d'isoler les jeunes de cette population de ces écoles d'Etat. S'il y avait même des élèves, à peine, ils arrivaient dans la dernière classe. C'est pourquoi dans la dernière classe de ces lycées ouverts et qu'ils furent rares, on a pu compter sur les doigts les élèves albanais tandis que la population albanaise faisait la majorité absolue dans tous les coins et contrées de la région.

Les abus, les offenses et les humiliations furent des formes ordinaires à l'adresse des enfants albanais avec l'intention de les déprimer psychologiquement et les désorienter au point de vue national. Par contre, malgré toutes les pressions de dénationalisation de la population albanaise, le manque d'enseignement vers les ans 30 (du XX siècle) pour les enfants albanais, qu'ils ont déjà commencé cette voie dure des connaissances, qui n'était pas seulement une idée mais une réalité, une peur de la bourgeoisie régnante qui se déclara ouvertement contre l'instruction albanaise.

Les efforts des Albanais de s'instruire dans le Medressée de Shkupi (Uscub) à l'émancipation religieuse ont donné des contre résultats tandis que le fondateur fut bien surpris

En concluant, il faut noter le fait que depuis le mouvement armée de 1918 jusqu'à son étouffement par écrit où par la force armée les Albanais demandèrent leurs écoles. Une telle lutte montra la maturité nationale albanaise pour l'enseignement, la culture, malgré toutes les oppressions et les conventions organisées inter — état pour assimiler les Albanais, n'arrivent pas à la réaliser.

Il serait injuste de ne pas dire que contre toute cette oppression éducative et culturelle, au niveau national de la population albanaise l'aide qu'offrait le Comité de la Région du P.C.Y. pour la Kosovë et la Metochie, qu'il accepte l'albanais comme langue égale, dans laquelle, il publie des proclamations s'adressant au peuple en albanais.

L'aide et l'appui de la classe révolutionnaire fut le couronnement de la lutte pour l'identité nationale. Le P.C.Y. dans cet examen dur, s'en tire avec honneur devant ce peuple pauvre et son histoire séculaire.